

Llaushë/Lauša. Po atë ditë, mori vendim që përmes malit të *Deviqit/Deviç* të shkonte te familja në Gillogoc/Glogovac. Nga ajo ditë, askush nuk e kishte parë më. Vetëm nga fundi i muajit mars të vitit 2005, familjes i është kumtuar se mbetjet mortore të Mustafës ishin gjetur më 30.10.2003 në pyllin *Deviq/Deviç*, në afërsi të manastirit ortodoks në Laushë/Lauša. Familjarët i kanë varrosur mbetjet mortore të Mustafës më 5.04.2005 në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata H.G, FDH-17307; OMPE, *Mbetjet...*, FDH-15297; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Sadri (Mustafë) Geci

(1926, shqiptar nga Llausha/Lauša, komuna e Skënderajt/Srbica, rojtar, dy fëmijë)

Përderisa zhvillohej sulmi i forcave serbe kundër Llaushës/Lauša [4.08.1998], Sadriu ishte i strehuar në pyjet e këtij fshati. Në mbrëmje, rreth orës 21:00, u kthye në shtëpi për ta ushqyer bagëtinë. Djali i vëllait Besimi e kishte takuar dhe ka bërë përpjekje që ta bindte të mos shkonte në fshat, sepse atje ende gjendeshin pjesëtarë të forcave serbe. Sadriu e refuzoi këtë dhe shkoi drejt shtëpisë së vet. Ishte kjo hera e fundit kur e shihnin të gjallë. Tri ditë më vonë dhe pas tërheqjes së forcave serbe, një i afërm i Sadriut, Musliu, e ka gjetur trupin e karbonizuar të Sadriut në shtëpinë e Hamit Gecit [Llaushë/Lauša]. E njohu në bazë të këpucëve. Sadriun e kanë varrosur ditën tjetër në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata B.G, FDH-17304; *Over 20 Albanians Killed in Latest Serb Offensive in Drenica*, pasqyra e lajmeve, KIC, 11.08.1998, FDH-29429.

Sami (Rrahim) Geci

(15.05.1972, shqiptar nga Llausha/Lauša, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, i pamartuar, pjesëtar i UÇK-së)

Samiu ka qenë pjesëtar i shtabit lokal të UÇK-së në fshatin e tij [Lauša/Lauša]. Nga fundi i muajit korrik të vitit 1998, me të atin Rrahimin, kushërinjtë Jakupin dhe Veliun dhe burra të tjerë të fshatit strehoheshin në pyjet e Llaushës/Lauša. Në datën

4.08.1998, ushtarët serb i kanë vërejtur Samiun, Rrahimin, Jakupin dhe Veliun dhe kanë shtënë në drejtim të tyre. Burrat u shpërndanë në të gjitha anët. Ditën tjetër, Rrahimi u takua me kushërinjtë, por Samiu mungonte. Për fatin e tij nuk dihet asgjë as sot e kësaj dite. Zhdukja e tij është regjistruar në regjistrin përkatës të KNKK-së dhe lënda e tij është sistemuar me numër BLG-804299-01.

Burimet: deklarata R.G, FDH-17302; *Over 20 Albanians Killed in Latest Serb Offensive in Drenica*, pasqyra e lajmeve, KIC, 11.08.1998, FDH-29429; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Ymer (Sefer) Hoxha

(10.05.1941, shqiptar nga Llausha/Lauša, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor ndërtimor, dy fëmijë)

Kur filluan sulmet kundër Llaushës/Lauša në mëngjesin e datës 4.08.1998, Ymeri ndodhej në shtëpi me bashkëshorten Fatimen dhe djalin Istrefin. Pas kafjallit, ai shkoi te komshiu Ramadan Geci. Pas pak, katër ushtarë serb me stemat e UÇK-së kanë hyrë me dhunë në shtëpinë e Ramadanit. I rrahën Ramadanin dhe Ymerin dhe, më pas, me rrobat e fëmijëve të Ramadanit u lidhën sytë, ndërkaq me kabllon telefonik duart dhe këmbët. Pastaj, i futën në xhipin e tyre. I çuan para dyqanit të Ramadanit. U bënë pyetje për djemtë e Ramadanit dhe për UÇK-në, duke i rrahur pandërprerë. Ymeri u bëri lutje që mos ta rrihin se ishte i sëmurë. Pas pak, Ramadanin e kanë futur në xhip dhe e kanë çuar deri te shtëpia, ndërkaq për Ymerin nuk ekziston nga ajo ditë asnjë gjurmë. Në regjistrin e të zhdukurve të KNKK-së, rasti i tij është sistemuar në lëndën me numër BLG-804099-01.

Burimet: deklarata F.H, FDH-17301; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex. P01426, FDH-35363; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Rrustem (Islam) Rreci

(30.11.1941, shqiptar nga Llausha/Lauša, komuna e Skënderajt/Srbica, bujk, dy fëmijë)

Nga fundi i muajit korrik të vitit 1998, Rrustemi me bashkëshorten dhe fëmijët